



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 19/07/2021 Ref.: 2801/21

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07.07.2021 mori:

#### V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Kolegji “Universi” në nivel institucional.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

Kolegji “Universi” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Kolegjin “Universi”, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional.

Vizitat është organizuar më 03.02.2021 me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Elene Jibladze, Dietmar Paier, Asnate Kažoka.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit institucional të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Kolegji “Universi”, nga gjithsej 11 kapituj të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit i përmbush standardet si vijon: substancialisht i përmbush tre (3) kapituj, ndërsa pjesërisht i përmbush tetë (8) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit "Universi", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Universi";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Hasnija Hazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

